

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.07.2023, ora 11:10 në ambjentet e Teatri Skampa, ku do të zhvillohet mbledhja me rastin e konstituimit të Këshillit Bashkiak Elbasan, zgjedhjes së kryetarit dhe 2 nënkryetarëve të këtij këshilli, si dhe të konstituimit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja. Marrin pjesë, anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, Kryetar i Bashkisë Z. Gledian Llatja, deputetët Z. Florenc Spaho, Prefekte Znj. Majlinda Perriu, përfaqësues të komuniteteve fetare Mysliman, Ortodoks dhe Katolik, Përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, 2 nënkryetarët e bashkisë, drejtorët e drejtorive dhe specialist, drejtues të institucioneve vartëse, specialistë të ndryshëm, media si dhe qytetarë të ndryshëm.

Elvi Çuni - Sekretar i Këshillit Bashkiak:

Mirë se keni ardhur. Në mungesë të Z. Bukurosh Stafja, rradha për drejtimin e mbledhjes i takon Z. Shefqet Bullari nga forca Partia Socialiste e Shqipërisë. Ndërkohë vazhdojmë me listëprezencën. Të pranishëm 47 anëtarë. Ia jap fjalën Z. Shefqet Bullari.

Z. Shefqet Bullari: Meqënëse kuorumi është i plotësuar, hap këtë mbledhje të parë të Këshillit Bashkiak. Është nder që përfaqësoj, të nderuar këshilltarë, kryetar i bashkisë, deputet, të fuar, m.q.s dokumentacioni plotësues i KQZ ekziston, shkresa e prefekturës, vërtetimi i njoftimit të njohjes së mandatit të kryetarit të bashkisë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Në zbatim të Nenit 48 të Ligjit nr.139/2015 zhvillojmë mbledhjen e parë të KB për konstituimin e tij. Këshilli i ri i bashkisë është i përfaqësuar nga disa subjekte politike. I uroj të gjithë këshilltarëve suksese në misionin tuaj. Kryetarit të bashkisë i uroj suksese dhe të vazhdojë punën me vizion që të realizojë objektivat dhe premtimet e dhëna.

Pika 1 e rendit të ditës – Zgjedhja e Komisionit të Mandateve.

Komisioni i mandateve do të përfaqësohet nga 3 anëtarë të cilët do të shikojnë vlefshmërinë e mandateve të anëtarëve dhe do të përgatisin raportin. Dy do të jenë nga forca e PS dhe një nga forca opozitare.

Propozimet për Komisionin e Mandateve:

Kryetar i grupit të PS Z. Hektor Çiftja propozon Znj. Luiza Popja dhe Z. Fatmir Vodollari.

Kryetar i grupit të BF Z. Blendi Himçi propozon Znj. Rudina Mita.

Z. Shefqet Bullari: *Votojnë për Komisionin e Mandateve këshilltarët. Me shumicë miratohet.*

Mblidhet Komisioni i Mandateve dhe cakton Kryetarin e Komisionit.

5 minuta pushim.

Komisioni i Mandateve i përbërë nga:

1. Luiza Popja Kryetare
2. Rudina Mita Zv. Kryetare
3. Fatmir Vodollari Sekretar

Komisioni mban procesverbalin për vërtetimin e mandateve të Këshillit Bashkiak Elbasan. Pas verifikimit të dokumentacionit konstatoi se marrin pjesë në mbledhje 47 anëtarë të pranishëm, nuk marrin pjesë në mbledhje 4 anëtarë. Vërtetohet vlefshmëria e mandateve për 47 anëtarët e pranishëm dhe nuk vërtetohet për 4 anëtarë, për arsye të mosparaqitjes për arsye personale.

Vërtetohen mandatet si më poshtë:

Subjekti BF : Blendi Ferninad Himçi, Rudina Jani Mita, Andi Ramazan Shtylla, Doris Adi Madhi, Ergys Ilmi Muzhaqi, Mimoza Dalip Trimi, Dritan Selim Cepa, Valbona Tefik Balliu, Artan Mustafa Cana, Amarda Gëzim Radi, Franko Bardhyl Hakilja, Armonela Simon Marku.

Subjekti PS: Ermira Durim Urupi, Imelda Qazim Sejдини, Hektor Tasim Çiftja, Jana Gori Zeqiri, Altin Enver Gjordumi, Lutfi Abdulla Lala, Luiza Shaban Popja, Fatmir Abaz Vodollari, Kejsi Kujtim Cakani, Anxjela Pirro Ziu, Ali Muhamed Mysliu, Daniela Besnik Sula, Arbi Resul Fetah, Eligerta Petrit Bardhi, Jemin Xhelal Tata, Esmeralda Qerim Mallosi, Shefqet Gani Bullari,

Ledjana Fatmir Pisha, Afrim Apostof Qosja, Luan Rexhep Rama, Enerieta Neki Ferra, Shpëtim Nezir Llapushi, Zana Mehdi Rapa, Rexhep Beqir Kaçuli.

Subjekti Demokracia Sociale: Sokol Petri Sinani

Subjekti Partia Social Demokrate: Erion Gëzim Murataj

Subjekti PD: Eugen Skënder Isaj, Aurora Yllson Domni, Naim Hasan Meta, Majlinda Adem Kaçuli, Zamir Petrit Muzhaqi, Bjanka Arjan Copja, Altin Sali Meçja.

Subjekti Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet: Lumturi Mehmet Hasa.

Subjekti PGJ: Indrit Hasan Abdiaj

Kryetari i Komisionit: *Iu uroj suksese të gjithë këshilltarëve. Në dosje ndodhet betimi të cilin duhet ta firmosni.*

Z. Shefqet Bullari: *Kush është dakord me raportin e Komisioneve të Mandateve? Miratohet raporti me shumicë votash.*

Z. Shefqet Bullari lexon formulën e betimit. Çdo këshilltarë betohet një nga një.

Mbajtëse e procesverbalit

Livia Guri



Enerieta Ferra



Luan Rama



Indrit Abdiaj



SEKRETARI

Elvi Çuni



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.07.2023, ora 11:10 në ambjentet e Teatri Skampa, ku do të zhvillohet mbledhja me rastin e konstituimit të Këshillit Bashkiak Elbasan, zgjedhjes së kryetarit dhe 2 nënkryetarëve të këtij këshilli, si dhe të konstituimit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja. Marrin pjesë, anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur, sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, kryetar I bashkisë Z. Gledian Llatja, deputetët Z. Florenc Spaho, Prefekte Znj. Majlinda Perriu, përfaqësues të komuniteteve fetare Mysliman, Ortodoks dhe Katolik, Përfaqësues I Prokurorisë së Përgjithshme Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, 2 nënkryetarët e bashkisë, drejtorët e drejtorive dhe specialist, drejtues të institucioneve vartëse, specialistë të ndryshëm, media si dhe qytetarë të ndryshëm.

Pika 2 e rendit të ditës – Zgjedhja e kryetarit të Këshillit Bashkiak.

Z. Shefqet Bullari: *Në bazë të rregullores së KB duhet të jenë 5 këshilltarë që të propozojnë 1 kandidatë dhe asnjë anëtarë nuk mund të bëj pjesë në më shumë se një grup. Kryetari zgjidhet pa debat, votimi bëhet i hapur.*

Z. Blendi Himçi: *Z. Bullari për procedurë, së pari më lejoni tju them se kjo mbledhje ka një problem, mungon rregullorja në çdo dosje të anëtarit të KB. Sipas rregullores forca më e madhe në këshill propozon kandidatin.*

Z. Bullari: *Votimi i fshehtë bëhet kur e kërkon 1/3 e këshilltarëve, pra 17 veta, ndryshe bëhet i hapur.*

Sekretari i KB Elvi Çuni: *Një ndërhyrje. Në rregullore citohet që mbi tavolinat e këshilltarëve në dosje duhet të jetë rendi i ditës, formula e betimit dhe kartonat e votimit.*

Z. Shefqet Bullari: *Ftoj përfaqësuesit të bëjnë propozimet për Komisionin e Votimit.*

Kryetar i grupit i PS Z. Hektori Çiftja propozon Z. Ilir Sadiku dhe Znj. Zana Rapa për Komisionin e Votimit.

Kryetar i grupit i PD Eugen Isaj: *I uroj suksese anëtarëve në katër vitet e ardhshme, të jemi në lartësinë e duhur dhe të arrijmë pritshmëritë. Për Komisionin e Votimit propozojmë Znj. Majlinda Kaçuli.*

Z. Blendi Himçi: *Nuk po e drejtoni mbledhjen siç duhet. Ju kujtoj se përfaqësuesi i takon opozitës më të madhe, nuk mund ta caktoni ju. i takon BF. Duke iu referuar rregullores dhe rregullores së Kuvendit të Shqipërisë si manual.*

Z. Shefqet Bullari: *Në rregulloren e Këshillit nuk është e përcaktuar nga cili caktohet Komisioni. Në një rregullore të re mind ta përcaktoni. Me balancë u llogarit në këtë mënyrë.*

Z. Blendi Himçi: *Referohuni dhe për analogji Rregullores së Kuvendit.*

Z. Shefqet Bullari: *E hedhim në votim. Kush është dakord që anëtarin tjetër të Komisionit Të Votimit ta ketë subjekti BF?*

Pas votimit, 12 vota pro, nuk miratohet.

Kush është dakord që anëtarin tjetër të Komisionit të Votimit ta ketë subjekti PD?

30 vota pro, pranohet me shumicën e votave.

Kush është dakord me krijimin e Komisionit të Votimit me këto anëtarë?

Miratohet me shumicë votash.

Vazhdojmë me propozimet për kryetar.

Grupi i PS me përfaqësues Z. Hektor Çiftja propozon Z. Lutfi Lala.

Grupi i PD dhe BF nuk bëjnë propozime për Kryetar të Këshillit Bashkiak.

Votim i hapur : 29 vota pro, 12 vota kundër, 7 vota abstenim.

Z. Blendi Himçi: *Duhet ta kishe hedhur në votim për ta bërë votimin të fshehtë.*

Z. Shefqet Bullari: *Nuk kishte propozime për votim të fshehtë.*

Pasi Komisioni i Votimit mblidhet, harton procesverbalin, e lexon atë me zë të lartë, dhe shpall si kryetar të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Lutfli Lala.

Z. Ilir Sadiku i uron suksese.

Z. Shefqet Bullari fton kryetarin e sapo

zgjedhur të KB të vazhdojë drejtimin e mbledhjes.

Fjala përshëndetëse e Z. Lutfli Lala kryetari i sapozgjedhur i Këshillit Bashkiak: *Të nderuar përfaqësues të KB, përfaqësues të partive politike, të nderuar deputetë dhe Kryetari i Bashkisë. Kjo ceremoni është e veçantë sepse betohem se do të realizojë pushtetin e atyre sipas ligjit. Unë jam shumë mirënjohës për besimin që më dhatë për Këshillin Bashkiak Elbasan dhe ju premtoj se këtë besim do ta shpërblejë për të rritur mirëqenien e qytetit tone. Bashkia ka një shtrirje të gjerë. Kjo le të shërbejë si cilësi e vendimarrjes. Unë si drejtues ju premtoj se do të jem njëri nga ju, pavarësisht se kujt partie i përkas.*

Enerieta Ferra




Luan Rama



Indrit Abdiaj

SEKRETARI
Elvi Çuni



Mbajtëse e procesverbalit
Livia Guri



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.07.2023, ora 11:10 në ambjentet e Teatri Skampa, ku do të zhvillohet mbledhja me rastin e konstituimit të Këshillit Bashkiak Elbasan, zgjedhjes së kryetarit dhe 2 nënkryetarëve të këtij këshilli, si dhe të konstituimit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja. Marrin pjesë, anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur, sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, kryetar I bashkisë Z. Gledian Llatja, deputetët Z. Florenc Spaho, Prefekte Znj. Majlinda Perriu, përfaqësues të komuniteteve fetare Mysliman, Ortodoks dhe Katolik, Përfaqësues I Prokurorisë së Përgjithshme Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, 2 nënkryetarët e bashkisë, drejtorët e drejtorive dhe specialist, drejtues të institucioneve vartëse, specialistë të ndryshëm, media si dhe qytetarë të ndryshëm.

Pika e 3 rendit të ditës – Zgjedhja e zv.kryetarëve të KB

Z. Lutfli Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: *Të drejtën për të propozuar e ka çdo grup këshilltarësh dhe çdo këshilltarë që ka 5 këshilltarë në grup. Nuk është e thënë se do të ketë vetëm 2 propozime. Ftoj të bëhen propozimet:*

Z. Hektor Çiftja: *Grupi i këshilltarëve të PS propozon si nënkryetare Znj. Enerieta Ferra*

Z. Blendi Himçi: *Në emër të koalicionit BF ne propozojmë për nënkryetare Znj. Valbona Balliu, një personalitet në qytetin e Elbasanit, një vlerë për arsimin dhe kontribut në jetën politike dhe për shoqërinë civile.*

Z. Eugen Isaj: *Në emër të 7 këshilltarëve të PD kam kënaqësinë të propozoj Z. Zamir Muzhaqi, me eksperiencë si sekretar qarku, anëtarë prej vitesh i KB, besoj një vlerë e shtuar dhe sigurisht përmbush këtë vend. Ju ftoj ta mbështesim.*

Z. Blendi Himçi: *Z. Lala ju uroj për pjesën e këshillit dhe në emër të grupit kërkoj nga ana juaj që kësaj mbledhje ti jepet serioziteti i duhur. Ka një rregullore të ndryshuar kur këshilli ishte monopartiak dhe është për të ardhur keq. Ka qenë një rregullore ku KB ka punuar katër vjet, ku i përputhej kërkesave dhe veprimtarisë së KB. Ka pas në thelbin e saj një balancë politike. Kjo opozitë i drejtohet numrit më të madh të mandateve që ka KB, ai vend i takon përfaqësuesit të*

opozitës me nr më të madh të anëtarëve dhe për në Komision. Nëse ju kërkoni të na përplasni bredna opozitës kjo nuk është normale.

Z. Lutfli Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: Përsa i përket rregullores nuk është në nivelin që thoni ju, plotëson parametrat për një rregullore të rregullt. Përsa i përket propozimeve siç e dim çdo shtetas shqiptar mbi 18 vjeç mund të zgjidhet dhe të zgjedhë, pra ju keni të drejtën të propozoni, unë nuk vura kushte vetëm për dy kandidatë. Dhe në rregullore apo në Ligjin 139/2015.

Z. Blendi Himçi: Ligji 139 ia delegon rregullores. Përsa i përket rregullores praktika e përfaqësimit i takon opozitës, në rregullore ju e keni hequr. E mëparshnja e specifikonte opozita që ka mandatet më të mëdhaja. Unë them ti referohemi asaj rregulloreje. Përderisa ka mbetur evasive dhe në këtë rregullore qëndron dhe një që e ka pasur model që është rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, ku është vendur që përfaqësuesin e kryetarit të Kuvendit ta ketë forca më e madhe opozitare. Nuk po flasim për të drejtën për të kandiduar, çfarë duhet, çfarë na pëlqen të bëjmë, këtu është çfarë duhet dhe kjo që po them qëndron sepse përfaqëson pjesën më të madhe të opozitës.

Z. Lutfi Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: Po ju them se duhen dy anëtarë nga këshilli si nënkryetar, një i forcës më të madhe dhe tjetri i krahut tjetër. Përveç kësaj votimi e përcakton. Ka propozime të tjera në lidhje me emrat e nënkryetarëve? Nëse jo sipas rradhës vazhdojmë me votimin.

Z. Blendi Himçi: Kërkesë për votim të fshehtë.

Z. Lutfli Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: E hedhim në votim për votim të fshehtë. Nuk arrihet kuorumi për votim të fshehtë.

Votat për Znj. Enerieta Ferra: 25 Pro, 4 Kundër, 7 Abstenim

Votat për Z. Zamir Muzhaqu: 32 Pro, 12 Kundër, 4 Abstenim

Votat për Znj. Valbona Balliu: 11 Pro, 30 Kundër, 7 Abstenim

Komisioni i Votimit shqyrtoi votat dhe i lexoi me zë të lartë.

Znj. Enerieta Ferra dhe Z. Zamir Muzhaqi zgjidhen nënkryetarë të Këshillit Bashkiak. Urime për detyrën e re.

Fjala përshëndetëse e Znj. Enerieta Ferra.

Enerieta Ferra

Luan Rama

Indrit Abdiaj

SEKRETARI
Elvi Çuni

Mbajtëse e procesverbalit

Livia Guri

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.07.2023, ora 11:10 në ambjentet e Teatri Skampa, ku do të zhvillohet mbledhja me rastin e konstituimit të Këshillit Bashkiak Elbasan, zgjedhjes së kryetarit dhe 2 nënkryetarëve të këtij këshilli, si dhe të konstituimit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja. Marrin pjesë, anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur, sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, kryetar I bashkisë Z. Gledian Llatja, deputetët Z. Florenc Spaho, Prefekte Znj. Majlinda Perriu, përfaqësues të komuniteteve fetare Mysliman, Ortodoks dhe Katolik, Përfaqësues I Prokurorisë së Përgjithshme Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, 2 nënkryetarët e bashkisë, drejtorët e drejtorive dhe specialist, drejtues të institucioneve vartëse, specialistë të ndryshëm, media si dhe qytetarë të ndryshëm.

Pika 4 e rendit të ditës. Ceremonia e marrjes së detyrës së kryetarit të bashkisë.

Z. Lutfli Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: *Ftoj Z. Llatja të na bashkohet. Para se kryetari të bëj betimin duhet vendimi i gjykatës, shpresa e prefekturës dhe më pas të bëj betimin në bazë të ligjit.*

Lexohet vendimi i gjykatës.

Z. Lutfli Lala lexon vendimin sipas ligjit.

Kryetari betohet.

Këndohet himni kombëtar.

Z. Lutfli Lala i vendos shiritin Kryetarit të Bashkisë.

Fjala përshëndetëse e kryetarit të bashkisë: *Ju uroj suksese në këtë mandate të ri të gjithë këshilltarëve, kryetarit, nënkryetarëve për një mandatë me shumë shpresë për qytetarët dhe më shumë punë që na përket ne. Kemi pasur një besim të plotë jo vetëm të socialistëve por të gjithë qytetarëve të Elbasanit. Një besim të cilin do ta shpërblejmë me punë dhe përkushtim. Uroj shumë që këtë KB në këtë mandat të ritë bëjmë gjëra të mira për Elbasanin, për qytetin, për fshatin, të bëjmë të mira për të zhvilluar dhe të bëjmë punë sa më shumë. Uroj të kemi consensus në parlamentin e qytetit për vendimarrje kryesore, zhvillimore të Elbasanit, për projekte të mëdha që ne i kemi nisur në këtë 4 vjeçar që sapo lam.*

Ju uroj suksese dhe jam i bundur se do të jetë mandati i ndryshimeve për Elbasanin. Dua të falenderoj të gjithë qytetarët e Elbasanit, jo vetëm socialistët por të gjithë ata që na mbështetën dhe na besuan. Të jesh kryetar kryetar bashkie, nuk je vetëm i atyre që të kanë votuar por i të gjithë qytetarëve që jetojnë, punojnë dhe duan përparimin e vendit të tyre.

Faleminderit të gjithëve.

Debat midis Z. Himçi dhe Znj. Ermira Urupi.

Enerieta Ferra

Luan Rama

Indrit Abdiaj

SEKRETARI
Elvi Çuni

Mbajtëse e procesverbalit

Livia Guri

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.07.2023, ora 11:10 në ambjentet e Teatri Skampa, ku do të zhvillohet mbledhja me rastin e konstituimit të Këshillit Bashkiak Elbasan, zgjedhjes së kryetarit dhe 2 nënkryetarëve të këtij këshilli, si dhe të konstituimit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja. Marrin pjesë, anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur, sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, kryetar I bashkisë Z. Gledian Llatja, deputetët Z. Florenc Spaho, Prefekte Znj. Majlinda Perriu, përfaqësues të komuniteteve fetare Mysliman, Ortodoks dhe Katolik, Përfaqësues I Prokurorisë së Përgjithshme Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, 2 nënkryetarët e bashkisë, drejtorët e drejtorive dhe specialist, drejtues të institucioneve vartëse, specialistë të ndryshëm, media si dhe qytetarë të ndryshëm.

Pika 5 e rendit të ditës. Zgjedhja e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë në Këshillin e Qarkut.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, bën citimin e shkresës së prefekturës për numrin e anëtarëve të Këshillit të Qarkut, Bashkia Elbasan ka 7+1 anëtarë, ku kryetarët e bashkive janë anëtarë të këshillit të qarkut. Në bazë të numrit të popullsisë kemi të drejtë të caktojmë 7 anëtarë për të përfaqësuar qarkun e Elbasanit. Ftoj grupet të bëjnë propozimet.

Z. Hektor Çiftja nga PS propozon: Znj Ermira Urupi, Z. Lutfi Lala, Znj.Imelda Sejdini, Z. Ali Mysliu, Z. Indrit Abdiaj, Z. Sokol Sinani dhe Znj. Lumturi Hasa.

Z. Blendi Himçi nga koalicioni BF propozon Z. Ergys Muzhaqi.

Votim i hapur.

1. Znj Ermira Urupi,	28 Pro,	Kundër,	6	Abstenim
2. Z. Lutfi Lala,	28 Pro, 12	Kundër,	7	Abstenim
3. Znj.Imelda Sejdini,	28 Pro, 12	Kundër,	7	Abstenim
4. Z. Ali Mysliu,	28 Pro, 12	Kundër,	7	Abstenim
5. Z. Indrit Abdiaj,	28 Pro, 12	Kundër,	7	Abstenim
6. Z. Sokol Sinani	28 Pro, 12	Kundër,	7	Abstenim
7. Znj. Lumturi Hasa	28 Pro, 12	Kundër,	7	Abstenim
8. Z. Ergys Muzhaqi	12 Pro, 12	Kundër,		Abstenim

Z. Lutfi Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: *Me përfundimin e votimit Komisioni lexon votat.*

Komisioni i Votimit lexon me zë të lartë votat për çdo kandidatë dhe shpall anëtarët e qarkut fitues Znj Ermira Urupi, Z. Lutfi Lala, Znj.Imelda Sejdini, Z. Ali Mysliu, Z. Indrit Abdiaj, Z. Sokol Sinani dhe Znj. Lumturi Hasa.

Z. Lutfli Lala Kryetar i Këshillit Bashkiak: *Pika e fundit e rendit të ditës u krye, edhe një herë duke ju falenderuar dhe duke ju uruar mbarësi këtij mandati bashkarisht me kryetarin me punë më të mira në favour të komunitetit. Faleminderit të gjithëve. Së shpejti do të jetë mbledhja tjetër në lidhje me grupet e Komisioneve.*

Mbledhja mbyllet në orën 12:40.

Enerieta Ferra



Luan Rama



Indrit Abdiaj

SEKRETARI
Elvi Cuni



Mbajtëse e procesverbalit

Livia Guri



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala

